



-
Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 19/15

Prishtinë, më 20.5.2015, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Safete Hadergjonaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza – Guvernator i BQK-së, Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Nahit Sharku – Zv. Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së, Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit të Kosovës, Istret Azemi – Drejtor i Buxhetit të Kuvendit të Kosovës, Valdete Daka - Kryetare e KQZ-së, Enis Halimi - Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, Sami Kurteshi – Avokat i Popullit, Miranda Meha nga KQZ, Basri Berisha – Zv. i Avokatit të Popullit dhe Jashar Kastrati nga IAP.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Alexandra Felingner dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga Zyra e Presidencës, Berat Begu nga BQK, Sulejman Blaku nga Kosova Sot, Besim Tosak nga Toskana Pres, Nebih Maxhuni nga Radio Dugagjini, Besart Galica nga RTK, Liridona Xhamaili nga RTV21, Nehat Dervishi nga OSBE

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2015;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari – konstatoj se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

Kryetari – theksoi se ligji për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësit, respektivisht neni 4, flet për përgjegjësinë dhe kompetencat e Bankes Qendrore në përcaktimin e policës të sigurisë. Ndërsa Byroja e sigurimit është vetëm institucion i cili i zbaton vendimet dhe i jep llogari Bankës Qendrore. Për ne është me rëndësi të njoftohemi për pengesat dhe për progresin në këtë drejtim. Të dhënat nga hulumtimi legjislativ dhe të dhënat të cilat janë marr nga statistikat e Bankës Qendrore, tregojnë se pagesat apo mbledhjet në kufi nga viti 2002-2014, janë shuma të mëdha rreth 131 milion euro. Ndërsa dëmet që janë paguar janë afërsisht 10 milion euro, që tregon për një diferencë të madhe. Kompanitë e sigurimit nuk kanë pas ndonjë vullnet për të shtyrë procesin e finalizimit të paisjes me Karton të Gjellbërt. Kur është bërë ligji për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegësia, kemi pasur informacion që pasi që të hyn ligji në fuqi, përafërsisht katër ose pesë muaj do të pajisemi me Kartonin e Gjellbërt. Përveç lirisë së qytetarëve është pengesë edhe në aspektin ekonomik, meqenëse pa Kartonin e Gjellbërt, kosovarët nuk mund të kenë kompani të shpëdicionit. Transporti i mallrave bëhet nga kompani të huaja apo kompani që paguhen shuma të mëdha për qarkullim. Ne më nuk jemi të bindur që mungesa e Kartonit të Gjellbërt, është si rezultat i mos-anëtarësimit në Kombet e Bashkuara, për arsye se kanë ekzistuar dhe ende ekziston forma të ndryshme të zgjidhjes së problemit. Mënyrat të cilat ne i kemi dëshiruar që të realizohen përkohësisht kanë qenë edhe marrëveshjet bilaterale të cilat nuk janë bërë. Fatkeqësisht janë bërë vetëm dy marrëveshje bilaterale me Maqedoninë dhe me Shqipërinë.

Bedri Hamza – Kosova me qëllim të plotësimit të kushteve formale për anëtarësim në Kartonin e Gjellbërt, i ka bërë disa veprime. Është aprovuar ligji dhe është themeluar byroja dhe po ashtu është themeluar fondi i garancisë nga kompanitë e sigurimeve prej 4 milion euro. Ka pasur tentativa dhe janë dërguar shkresa me qëllim të anëtarësimit të Kosovës me këtë institucion. Mirëpo duke pasur për bazë disa pengesa të natyrës formale, Kosova nuk ka arritur që të antarsohet në Kartonin e Gjellbërt. Sa i përket ndryshimit të tarifave si procedurë kërkohet që profesionistët të bëjnë kalkulimin dhe të dërgohet në Asamblen e Përgjithëshme të kompanive të sigurimit që të merret vendimi dhe të dërgohet në Byronë Kosovare të sigurimeve dhe Byroja të kërkoj aprovim prej Bankës Qendrore. Ju siguroj që në momentin kur e pranoj këtë pa asnjë vonesë brenda afateve ligjore ne do ti aprovojmë tarifën për ulje e jo ngritje. Çështja e dytë ka të bëjë me negociatat në Bruksel për marrëveshjen e memorandumit të mirëkuptimit mes Kosovës dhe Serbisë që është pozitive që mundëson lirinë e qytetarëve të dy shteteve pa pengesa dhe pa nevojën që të paguajnë polica kufitare. Nëse arrihet marrëveshja atëherë ka mundësi që Byroja Evropiane e Kartonit Gjellbërt të hapë një zyre që mundëson shitjen e Kartonit Gjellbërt në Kosovë. Mirëpo përveç këtyre anëve pozitive të përmenduar ka edhe efektin tjetër sepse po aq sa është lobuar për anëtarësim është lobuar edhe për mos anëtarësim prej shteteve dhe adresave tjera. Një alternative tjetër që nuk është punuar sa duhet nga të gjithë ne është modeli dhe analogjia e Malit të Zi, e cila ka përdorur Kartonin e Gjellbërt të Serbisë për ti mundësuar qytetarëve të këtij shteti për të lëvizur në vendet e Evropës. Është biseduar me Shqipërinë në këtë drejtim, mirëpo dhe për shkak se ndoshta edhe ata nuk e kanë kryer obligimin e tyre në nivelin e kërkuar një gjë e tillë nuk është pranuar dhe andaj duhet të mendohet për shtetet tjera për marrëveshje. Mundësia tjetër është që pas negociatave në Bruksel dhe finalizimit me sukses të kësaj të hapet mundësia për marrëveshje bilaterale që është rrugë pak më e gjatë dhe e vështirë dhe ka nevojë të negociohet me shtete veç e veç. Ne do ta shqyrtojmë edhe mundësinë ligjore që deri kur neve na lejon ligji që edhe pa propozimin e tyre me pa se me tarifën e cila aplikohet janë të kalkuluar drejtë.

Ilir Deda – Byroja Kosovare e Sigurimeve nuk mund ta anashkalojë një vullnet të gjithmbarshëm politik i cili ekziston për shkak të përfitimeve që ata i kanë. Ne nuk mund të jemi të gjithë në pritje se qka do të vendosin ata dhe ne duhet të bëjmë më shumë presion, sepse përfitimet e tyre janë irrelevante në krahasim me punën që duhet bëjmë. Nga ajo që ju e theksuat, procesi mund të zgjasë me vite. Ne nuk mund të vijmë në muajin shtator dhe të shohim se nuk është bërë çka kërkohet të bëhet, sepse kjo Byro nuk i ka ndërmarr hapat dhe është arsyetuar me procedura. A ka mundësi të dimë për një listë të institucioneve dhe çka mund të bëjmë ne që të përshpejtohet marrja vendimi që po kërkohet të merret?

Enver Hoti – nga bisedat është vërejtur se ka pasur ndoshta një mos anagazhim të duhur në këtë drejtim dhe në bazë të statistikave, vërehet se tarifat e sigurimit kufitar kanë qenë të larta. A ekzistojnë dallimet në mes tarifave të qytetarëve të Malit të Zi dhe të Serbisë që hyjnë në Kosovë dhe nëse ka dallime të tilla pse ndodh kjo, ju si Guvernator qka keni bërë që kjo të mos ndodh? Pse Banka Qendrore nuk ka inicuar zvogëlimin e tarifave dhe kjo është bërë si pengesë dhe pse duhet të vjenë nga kompanitë ose nga situata tjera politike? Sipas analizës, taksa kufitare e automjeteve është mbi 14 milion euro, ndërsa të mbledhura vetëm 1.3 milion euro për pagesa të dëmëve apo 9% për investime, që është një dallim shumë i madh. Duke u ndërlidhur me këtë dhe duke ditur se Banka Qendrore e kontrollon buxhetin e Byrosë, në çfarë mënyre i keni lejuar Byrosë shfrytëzimin e këtyre mjeteve? Pagat e drejtorëve dhe zv. drejtorëve llogariten se janë të larta dhe si i përcaktojnë këto mjete në bazë të çfarë kriteresh? Konsiderojmë që parat e bashkatdhetarëve po vazhdojnë të keqmenaxhohen në formë institucionale dhe për përfitime individuale, sepse ka mundur që të ndërhyet me kohë dhe nuk ka pas angazhim shtes për qëllim të vetëm të përfitimeve individuale dhe grupe. Nga hulumtimi legjislativ që është në faqen 9 ofrohen tri mundësi të zgjidhjeve. Propozoj që Komisioni dhe Guvernatori të mbështesin propozimin e tretë që Byroja të krijoj fondin në dispozicion nga të hyrat e veta.

Besa Gaxherri - A keni bërë analizë konkrete se sa përqind duhet të ulen këto tarifa? Ne nuk duhet të lakmojmë regjionit sepse ne kemi obligim më shumë ndaj bashkatdhetarëve. A mundet të përdoret dhe a keni filluar me bisedue me Shqipërinë, për përdorimin e Kartonit e Gjellbërt të Shqipërisë? Pajtohem me kolegun që Byroja e sigurimeve duhet të ofrojë fond. E kam parasysh që Qeveria nuk ka mundësi buxhetore me ndarë fond për këtë çështje, andaj ne duhet urgjentisht ta rregullojmë këtë çështje përmes ndërhyrjeve në ligj.

Bedri Hamza – sa i përket qështjes së pagesës së tarifave është qështje që ne presim të reduktohet dhe kjo besojë se do të ndodh para muajit korrik. Çështja e lobimit apo përkrahja prej Kuvendit dhe Qeverisë është e nevojshme. Gjithsesi edhe Banka Qendrore brenda kapaciteteve të veta profesionale do të bëjë lobim. Pa një angazhim të institucioneve është vështirë që të arrihet deri te një memorandum i mirëkuptimit me shtete apo deri te përdorimi i Kartonit Gjellbërt të një shteti të tretë. Ne kemi mundësi të bëjmë ekzaminime. Krijimi i fondit nga Byroja dhe mjetet të cilat mblidhen nga këto tarifa nuk mbesin në dispozicion e Byrosë, ata i përdorin një pjesë të tyre për mbulim të shpenzimeve operacionale dhe pjesën tjetër për ndarje të rezervave teknike. Tek shpenzimet operacionale sigurisht që mund të ngritet pytyja se a janë të larta apo të ulta dhe a janë menaxhuar mirë apo jo.

Kryetari – njoftoj se ne duhet të mobilizohemi për një lobim më të fuqishëm sidomos Qeveria, Banka Qendrore edhe Byroja Kosovare e Sigurimeve për një qasje më të mirë dhe më të shpejt për anëtarësim në Byronë e Kartonit Gjellbërt në Bruksel. Si alternativë deri në anëtarësim, hapi i parë që vetëm po ndërmerret është zvogëlimi i tarifës kufitare. Si alternativë e dytë është hapja e një zyre te një shteti kredibil që i ka raportet e mira me Byronë e Kartonit Gjellbert të Brukselit, që qytetarët e Kosovës të pajisen në Prishtinë me Kartonin e Gjellbërt. Ne do të shikojmë që deri në shtator sa do të lëviz kjo çështje dhe nëse nuk ka lëvizë të këtyre alternativave të cilat ne i përmendëm, atëherë ne si komision funksional do të qasemi ndryshim dhe plotësimit të ligjit, i cili i adaptohet rrethanave ekzistuese.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Kryetari – projektligji i tretë ti pakos fiskale të cilën e ka përgatitur Ministria e Financave ka të bëjë me ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Avdullah Hoti – projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar është derivat i programit qeverisës së bashku me dy ligjet tjera dhe kanë për qëllim që të krijoj një ambient më të mirë për bizneset në Kosovë

dhe për investime të reja në veqanti për bizneset e vogla dhe ka për qëllim të ngrit punësimin me këto ndryshime. Ndryshimi kryesor është ulja e pragut të TVSH-së në 30,000 të qarkullimit të bizneseve. Nuk ka kosto shtesë për biznese që hyjnë në këtë prag të TVSH-së. Ndryshimi i dytë është përshkallëzimi i TVSH-së që shkohet me një normë zero për një listë esenciale të mallrave dhe pastaj ulja prej 16% në 8% për bukë, krip, vaj, ngrohje, mbeturina dhe ujë për mallra dhe shërbime. Një ndryshim tjetër është heqja e TVSH-së nga të gjitha linjat e prodhimit për të promovuar investimet dhe heqja e TVSH-së nga importi i teknologjise informative. Do të mbahen norma e sheshtë e TVSH-së për bujqit që do të përcaktohet me një udhëzim të veçantë administrativ dhe janë rregulluar procedurat e regjistrimit dhe çregjistrimit në TVSH. Me këtë ligj hiqet TVSH-ja nga rastet e donacioneve edhe kur Qeveria merr pjesë deri në 20%. Rimbursimi është me procedura shumë më të shpejta sidomos për bizneset. Po ashtu ligji ka plotë ndryshime tjera teknike që janë vërejtur që janë mangësi dhe tash po përmirësohen.

Kryetari – ajo çka është me rëndësi për neve është që shporta familjare si trajtohet me këtë ligj të ri. Po ashtu është e rëndësishme për njoftim se cilat janë kapacitetet e ATK-së për të hyrë në funksion të plotë një ligj i cili tash ka një sistem krejtësisht tjetër. Një çështje me rëndësi është se në këtë ligj si trajtohet apo a është thjeshtësuar çështja e rimbursimit me qenë se ka pasur një burokraci në kthimin e TVSH-së. Ne si Komision më shumë profesional se politik, jemi për atë që të mbështesim reformat fiskale të qeverisë dhe të gjejmë format më të mira të të bërit biznes dhe mundësinë e rritjes së të hyrave për buxhetin e Kosovës.

Ilir Deda – a ka përgatitje të institucioneve për kontratë të mirëfilltë prej fillimit të zbatimit të ligji, dhe a mund të këtë abuzime me zbatimin e këtij ligji dhe me uljen e TVSH-së? Një pyetje që në ligj e kam kuptuar ndryshe e tani nuk e dëgjova, mielli i importuar a është 0% apo 8%? Çka ndodh me ato biznese tregtare të cilat vendosin të mos e respektojnë ligjin, duke mos e ulur TVSH-në në këtë listë të gjatë të produkteve të cilat parashihen me ligj. A kemi kapacitetet kontrolluese në të gjithë Kosovën dhe cilat do të jenë ndëshkimet për ata të cilët nuk e zbatojnë këtë ligj?

Avdullah Hoti – përveç që e kemi bërë këtë reformë fiskale ne e kemi bërë përgatitjen brenda ATK-së dhe përgatitjen e plotë të udhëzimeve administrative për të implementuar këtë ligj nga data 1 korrik të këtij viti. Edhe sistemet e IT-së po përshtaten që në momentin që aprovohet në Kuvend të fillon implementimi. Ato biznese që nuk e respektojnë ligjin ndëshkohen. Ne i kemi kryer konsultimet me grupet e interesit dhe mund të them që 99% të rasteve që ka pas komente, vlerësime dhe sugjerimet nga shoqata, bizneset dhe sektorët të ndryshëm, i kemi përfshirë me ligj dhe në disa raste mundësohet edhe me udhëzime administrative ti implementojmë disa prej sugjerimeve që mund të kenë bizneset. Nuk pritet të këtë abuzime për normat e përshkallëzuar prej kësaj liste të prezantuar për 8% dhe çmimi përcaktohet në treg.

Nahit Sharku – në përgatitjen e Ligjit të TVSH-së është marrë parasysh edhe mundësia buxhetore dhe analizat e ekonomisë për çështjet që parashohin qëndrueshmërinë fiskale. Sa i përket miellit të importuar në ligj parashihet qartë që mielli si lëndë e parë për prodhimin e bukës janë të parapara me procedurë për shfrytëzimin dhe po ashtu udhëzimi administrativ do të rregullohet dhe specifikohet, të cilat duhet respektuar për shfrytëzim. Po ashtu Ligji i TVSH-së mundëson që të bëhet një harmonizim i tërësishëm në sistemin tatimor të Kosovës me sistemin tatimor të TVSH-së në regjion dhe normat të cilat janë të parapara me këtë ligjin janë brenda standardeve të BE-së, qoftë në kufirin e normës së lartë apo edhe të ulët. Për herë të parë parashihet plotësimi i kërkesave të biznesit për lirin e makinerisë, që mos të paguhet në kufi por brenda vendit.

Bardhyl Meta - krejt çështjet që janë përfshirë në këtë diskutim vijnë nga katalogu i odave të kaluar. Mbetet ta shohim se si është rregulluar rimbursimi i TVSH-së sepse ka qenë një problem më shumë

burokratik se sa ligjor. Kisha lutur që të vazhdojë dialogu me biznese dhe sa të hynë ligji në fuqi me e pa se cilat jenë reperkusionet.

Enver Hoti - e mbështesim këtë projektligj dhe reformat e ministrisë së financave. Por, natyrisht kemi edhe disa propozime që do ti paraqesim gjatë procedimit të mëtutjeshëm të projektligjit.

Besa Gaxherri – ju përgëzojë si ministri e financave se keni bërë një punë të madhe me këto projektligje me të cilat po bëhet reformë e vërtetë fiskale. Po ashtu e përgëzojë edhe ATK-në, por kërkojë punë më të madhe në terren, sidomos edhe në regjione. Përndryshe ky ligj është shumë i mirëseardhur sikurse edhe ligjet tjera të pakos fiskale.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2015

Ismet Krasniqi – nga të dhënat e prezantuar në raport, për tremujorin e parë të vitit 2015, buxhet i Kuvendit është shpenzuar 70.13%. Më pas sekretari prezantoi shpenzimet sipas kategorive kryesore të shpenzimeve.

Kryetari – sa i përket shpenzimeve të karburantit, në bazë të të dhënave që kam përpara për shpenzimet e atyre që përdorin automjetet zyrtare të Kuvendit, shohim se anëtarja e kryesisë, Duda Balje ka shpenzuar më së shumti për karburant apo ka bërë 12,070 km që është dhjetëfishi më i madh se të tjerët. Por nuk qëndron keq as Glauk Konjufca që për tre muaj ka përdorur makinën zyrtare për 6,017 km. Edhe me rastin e shqyrtimit të raportin vjetor të Kuvendit, e kemi tërhequr vërejtjet për shpenzimet e mëdha për karburant dhe po shihet se disa deputetë vazhdojnë me shpenzimet të tilla.

Latif Gashi - kjo çështje është ngritur edhe në të kaluarën dhe nëse ligji nuk i limiton shpenzimet e tilla është mirë nëse si komision me i propozue plotësimet dhe ndryshimet, e mos t'iu lëmë këtyre deputetëve në ndërgjegjen e tyre, por ti obligojmë me ligj.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2015.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014

Kryetari – në bazë të të dhënave të prezantuara në raport, shohim se KQZ në vitin 2014, ka shpenzuar buxhetin në total 85.85%. Tek paga dhe mëditjet janë përfshirë mjetet si rezultat i rritjes së pagave prej 25% me vendim të qeverisë. Te mallrat dhe shërbimet ka pasur shkurtime përsëri me vendim të qeverisë prej 15%.

Valdete Daka - si KQZ në viti 2014 kemi pasur disa shpenzime të jashtëzakonshme, përveç atyre të cilat i kemi pasur të parapara sepse në fillim të vitit janë shpallur zgjedhjet e jashtëzakonshme për komunat në Mitrovicën Veriore dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare në qershor. Për këtë shkak është dashur të kërkojmë një buxhet shtesë nga qeveria, i cila na është aprovuar.

Besa Gaxherri – theksoi se shpenzimeve zyrtare jashtë vendit, akomodimi gjatë udhëtimit jashtë vendit dhe shpenzimet tjera jashtë vendit janë 97,580 euro, për të cilat do të ishte mirë një shpjegim? Shpenzimet postare mua po më duken se as 50% nuk janë shpenzuar, sepse adresat e juaja kanë qenë veç sa me i dërgue dërgesat, pa ditur se a arrijnë destinacionin e caktuar. Për dërgesa dhe fleta janë shpenzuar 47,000 euro, pse nuk keni ndërmarrë diçka? Te shërbimet kontraktuese tjera është një shpenzim prej 3,641,000 euro, ju lutem të na jepni sqarim? Po ashtu për furnizim, dreka zyrtare, pije e ushqim gjithsej i keni 23,000 euro, të na sqaroni?

Ilir Deda – desha të pyes në lidhje me mos plotësimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sidomos të dobësitë të cilat i ka gjetur auditori për punët jashtë orarit, rekrutimin e stafit profesional, shtesat për pune shtesë që nuk janë në përputhje me ligjin e shërbimit civil. Auditimi vazhdimisht bënë vërejtje dhe KQZ nuk i ka adresuar këto vërejtje deri më sot. Për udhëtimet jashtë vendit po mungon edhe bartja e njohurive të fituara nga këto vizita studimore, gjë që edhe ekziston vërejtja e auditorit për rekrutimin e stafit më të dobët se sa duhet. Te prokurimi, auditori po ashtu ka gjetur shumë parregullsi në procedurat e interesit, specifikat dhe vlerësimi i ulët. Çfarë po ndodh këtu, si i shpjegoni këto, kur jeni edhe pjesë e procesit gjyqësor?

Latif Gashi – për aq sa kam pasur rast të shfletojë këtë raport është përgatitur mirë. Këtë institucion vazhdimisht e ka përcjell çështja e problemit me paga dhe ky institucion shumë i rëndësishëm nuk është i trajtuar si institucionet tjera të themeluar nga Kuvendi. Në raport, në faqen 90 është bërë një krahasim me pagat e personelit të këtij institucioni me institucionet tjera dhe për shembull 97% dallon me Gjykatën Kushtetuese, dhe ajo që u ngritë për mungesën e kuadrove profesionale, ndoshta kjo ndikon që kuadrat nuk janë të interesuara të punësohen në këtë institucion.

Kryetari - sa i përket pagave, ne e dimë që KQZ është institucion kushtetues dhe anëtarët e këtij komisioni i emëron Presidentja. Ne si komisioni mund të bëjmë rekomandim për ministrinë e financave për çështjen e pagave por jo për Kuvend.

Enver Hoti - duke iu referuar strukturës organizative të sekretariatit të KQZ-së, Zyra e regjistrimit të partive, e ka zyrtarin e lartë për partitë politike, por ju duhet ta keni edhe një listë të shpenzimeve të partive politike. A keni informacione mbi gjendjen financiare të partive politike, ku janë pengesat pse nuk ju raportojnë partitë politike?

Valdete Daka – Sa i përket Zyrës për regjistrimin e partive politike, auditimi i financimit të subjekteve politike në bazë të ligjit bëhet nga Kuvendi dhe jo nga KQZ. Zyrtari financiar është vetëm me bërë shpërndarjen e buxhetit për grupet parlamentare. Në raport është e paraqitur si dëshmi si bëhet ndarja e buxhetit, shpenzimi i tij, por nuk kemi kompetenca me bë auditimin e shpenzimeve të subjekteve politike. Sa i përket shërbimeve postare është e vërtetë se kemi pasur një vlerë shumë të madhe, por kjo ka ndodhur se kemi pasur një numër të madh votuesish jashtë vendit. Kurse shërbimet tjera postare kanë të bëjnë me dërgimin e postës shërbyesve të rinj. Sa i përket informimit publik unë nuk e di se kemi ndonjë apo jemi të akuzuar. Unë si kryetare nuk kam bërë nënshkrimin e kontratës dhe OSHP-ja e ka kthyer tenderin dhe jo për parregullsi të tjera. Pas që e kam nënshkruar kontratën si zyrtarja më e lartë me kompaninë fituese gjithçka ka qenë në rregull dhe tenderi është përfunduar. Sa i përket udhëtimeve jashtë vendit ndoshta kanë qenë më të larta këtë vit, por ne kemi pasur dy parë zgjedhje dhe e kemi për obligim të shikojmë mbikëqyrjen e fletëvotimeve dhe në ato votime shkojnë anëtarët dhe sekretariati e

qëndrojnë deri sa të shtypen fletëvotimet, ashtu e parasheh ligji. Në këtë aspekt ka edhe një çështje tjetër sepse ne jemi anëtarësuar në organizata botërore dhe është me interes për KQZ në pjesëmarrjen në takimet e nivele të tilla për të marrë përvojat e vendeve tjera.

Besa Gaxherri – sa i përket shërbimeve postare nuk është kryer puna mirë, letrat janë hedhur nëpër kontiniera. E para stafi nuk i ka dërguar adresat mirë dhe e dyta përveç shpenzimit për shërbime postare ju keni shpenzuar edhe 30,662 euro për informim publik. Unë nuk po them se janë shpenzuare shumë por informimi është dashur të jetë më i mirë dhe në adresa të sakta. Tek veturat për regjistrimi të automjeteve nuk e di sa vettura keni, por për sigurimin e automjeteve figuron shuma 855 euro, ndërsa 5893 euro e keni sigurimin, mirëmbajtja është 10,000 euro. Ndoshta sigurimin e veturave e keni bërë KASKO? Pastaj shpenzimet e teknologjisë informative 168,000 euro, ndërsa mirëmbajtja e tyre është 9,000 euro. Po ashtu eksiton një shumë mbi 3 milion euro tek shërbimet kontraktuese. Për këto ka nevojë të jepen sqarime?

Enver Hoti - do të lidhem me deklarinimin e porositë prej 1,800,000 për fletëvotimet për regjistrimin e popullatës në vitin 2011, pse kanë ndodhur këto?

Valdete Daka – sa i përket adresave, deputetja ka të drejtë por ne i marrim regjistrin civil apo ekstraktin nga agjencioni i regjistrimit civil dhe ne nuk i shqyrtojmë a janë të sakta po jo. Ne jemi të obliguar me e dërgue postën në bazë të këtyre adresave dhe ne nuk e mirëmbajmë apo azhurnojmë regjistrin civil, përpos nëse dikush kërkon me i ndryshue adresën dhe na njofton se prej kësaj date jam në këtë adresë, vetëm për informatë.

Enis Halimi – buxheti është planifikuar për zgjedhje të rregullta që zgjasin katër deri në gjashtë muaj dhe ne e dimë se zgjedhjet në vitin e kaluar kanë qenë të parakohshme dhe si rrjedhojë afatet e organizimit të tyre janë shkurtuar, dhe kjo ka qenë arsyeja që nuk është shpenzuar buxheti i planifikuar. Sa i përket stafit kemi pasur konkurset ka pas të interesuar por kriteret ligjore nuk janë plotësuar dhe nuk kemi rekrutuar staf që nuk i kanë plotësuar kushtet. Është e vërtetë që për shkak të resurseve të vogla e kemi caktuar një zyrtar në një detyrë që na është thënë se është konflikt interesi dhe ne kemi reaguar dhe për atë pozitë kemi rekrutuar një person tjetër dhe kjo punë është rregulluar.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014

Kryetari - raporti është i përpiluar mirë, nuk ka tejkalime të shpenzimeve.

Sami Kurteshi - sa i përket buxhetit ka qenë sipas kërkesës tonë. Më pas prezantohet shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Ne jemi një ndertës ku nuk ka hapësira të mjaftueshme dhe e kemi ndaluar çdo lloj investimi apo punësimi sepse nuk kemi vend as për praktikant. Mund t'iu them se reprezentacionin e kemi hequr, shpenzimet për telefoni mobile i kemi zbritur në 70% apo 60%, nuk kemi mëditje për borde. Nga raporti i auditimit nuk kanë gjetur asgjë që është bërë shkelje.

Latif Gashi – është e vërtetë se kemi një raport të mirë që tregon për një menaxhim më të mirë dhe më vjenë mirë sepse kësaj radhe nuk kemi ankesa në lidhje me shpenzimet nga buxheti i caktuar dhe jam pro këtij raporti.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni unanimitas nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratohet Raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014.

7. Të ndryshme

7.1. Kryetari – njoftoj se ka ardhur qarkorja buxhetore e parë nga ministria e financave për përgatitjen e buxhetit 2016. Ne si Komision së bashku me administratën duhet të përgatisim buxhetin e Kuvendit për vitin e ardhshëm, i cili miratohet në Kryesi i dërgohet ministrisë së financave. Komisioni caktojë Bardhyl Meta dhe Ilir Deda, si përfaqësues të komisionit për të bashkëpunuar me administratën e Kuvendit në përgatitjen e kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2016.

7.2. Latif Gashi – njoftoj se grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve për Ligjin për Prokurimin Publik, me mbështetjen e stafit ka bërë disa kërkesa për institucionet që kanë qenë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe kemi kërkuar përgjigje me shkrim, të cilat i kemi pranuar nga Zyra e Kryeministrit, IKAP dhe KRPP. Në bazë të përgjigjeve të tyre kemi kuptuar se të gjitha rekomandimet janë adresuar, dhe Zyra e Kryeministrit ka njoftuar se tashmë është krijuar grupi punues në nivel qeveritar për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, dhe të gjitha rekomandimet e Komisionit, do të merren parasysh gjatë punës së amendamentit të ligjit. Grupi punues ka bërë një punë të mirë dhe mendojë që ne si komision e presim plotësimin dhe ndryshimin e ligjit, ku pastaj do të verifikojmë përfshirjen e rekomandimeve që kanë dalur nga monitorimi i ligjit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani